



Data: 29/07/2019

Ref.: 1377/19y

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Ekonomi e aplikuar dhe menaxhment, BSc 180 ECTS (gjuhë angleze), maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Ekonomik ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programit të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin Ekonomik më datë 11.06.2019 me qëllim të vlerësimit të programit të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Magdalena Platis dhe znj. Delia Gologan.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit Ekonomik dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se programi i studimit Ekonomi e aplikuar dhe menaxhment, BSc (gjuhë angleze) i ofruar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik përmbushë substancialisht standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit Ekonomik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

